

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 23.02.2023*

**Data 23.02.2023  
Ora 18:32**

**RENDI I DITËS**

*Projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin nr. 2, datë 31.01.2023, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 ””.*

**PJESËMARRJA:**

- **KQZ:**
- **Komisioni Rregullator:**

<b>Ilirjana NANO</b>	<b>Kryetare</b>
<b>Arens ÇELA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Dritan ÇAKA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Helga VUKAJ</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Muharrem ÇAKAJ</b>	<b>Anëtar</b>
- **Stafi i KQZ-së:** **Y. Merkaj, M. Koja,**
  - **Parti Politike:** **PL (A. Kaziaj)**
  - **OJQ:** **KRIIK**

*Znj. I. Nano:* Mirëmbërëma! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të administratës, përfaqësues të partive politike dhe të organizatave të shoqërisë civile. Në mbledhjen e sotme në rendin e ditës kemi 2 akte për të shqyrtuar.

1

*Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa*




**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 23.02.2023**

Pika 1 e rendit të ditës: shqyrtimi i projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin nr. 2, datë 31.01.2023, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 ””.

Pika 2 e rendit të ditës: shqyrtimi i projektvendimit “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.” Të dyja projektvendimet kanë ardhur si propozim i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Po zonja Vukaj, kishit diçka?

**Znj. H. Vukaj:** Para se të kalojmë te pyetja nëse kemi apo s’kemi diçka jashtë rendit të ditës, një konstatim i kahershëm, por që në kuadër të dinamikës dhe gjithë procesit të ngarkuar, që ka secili nga ne (nuk është shmangur, por me sa duket e gjeti sot momentin për t’u shprehur), është që për një plotësim formal dhe procedural të mbledhjeve, zoti sekretar i Përgjithshëm kërkoi personalisht që mbledhja të shoqërohet me procesverbalin qarkullues të prezencës së anëtarëve. Ky procesverbal duhet të ishte që në krye të herës si pjesë e këtij procesi administrativ dhe normal është pjesë formale e dosierit që krijohet për çdo mbledhje. Kështu që unë do të propozoja që sot ky procesverbal të bëhet efektiv, qoftë edhe në fund të mbledhjes dhe të qarkullonte te secili anëtar dhe më pas të administrohej në sektorët me të cilët lidhet. Kjo do të lehtësonte secilin nga ne për të memorizuar apo për të mbajtur një listë mbledhjesh qoftë për statistikë apo për kërkesa të tjera, që lidhen me institucionin. Faleminderit!

**Zbardhi materialin audio**  
**Eneida Stefa**  


**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 23.02.2023**

**Znj. I. Nano:** Faleminderit, zonja Vukaj! Ka çështje jashtë rendit të ditës për të diskutuar?


**Znj. H. Vukaj:** Po, pas diskutimit të akteve, kam çështje jashtë rendit të ditës.

**Znj. I. Nano:** Kolegë të tjerë, anëtarë të rregullatorit, kemi çështje jashtë rendit të ditës për të diskutuar? Vetëm zonja Vukaj. Po, zoti Merkaj.

**Z. Y. Merkaj:** Po, zonja kryetare. Me porosi të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve kërkoj të tërheq projektvendimin “Për disa ndryshime në vendimin nr. 2, datë 31.01.2023 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet në organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023””, për arsye teknike për një konsultim të mëtejshëm brenda KQZ-së. Ju faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Dakord. Është e drejta e propozuesit që pa filluar shqyrtimi i projektaktit të mund ta tërheqë, kështu që ngelet për shqyrtim vetëm një projektvendim. Pra, vetëm rendin e ditës i bie të votojmë. Heqim nga rendi i ditës pikën e parë të tij. Kolegë, dakord për ndryshim e rendit të ditës? Dakord.

**Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 23.02.2023*

Data 23.02.2023  
Ora 18:36


*RENDI I DITËS*

*Projektvendimi “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”*

*PJESËMARRJA:*

- KQZ:
- Komisioni Rregullator:
  - Ilijana NANO Kryetare
  - Arens ÇELA Anëtar
  - Dritan ÇAKA Anëtar
  - Helga VUKAJ Anëtare
  - Muharrem ÇAKAJ Anëtar
- Stafi i KQZ-së: Y. Merkaj, M. Koja,
  - Parti Politike: PL (A. Kaziaj)
  - OJQ: KRIIK

*Znj. I. Nano:* Atëherë vazhdojmë me pikën e dytë, shqyrtimi i projektvendimit “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.” Edhe ky projektvendim ka ardhur si propozim i Komisionerit Shtetëror




**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 23.02.2023**

të Zgjedhjeve. Zoti Merkaj, ju lutem një prezantim të shkurtër të projektatit dhe shpjegimeve përkatëse!

**Z. Y. Merkaj:** Faleminderit! Neni 95, pika 5 e Kodit Zgjedhor parashikon kompetencën e KQZ-së për organizimin e hedhjes së shortit dhe detyrimet që rrjedhin nga ky nen menjëherë sapo të ketë përfunduar regjistrimi i listës shumëmemërore në KQZ, apo sipas rastit në KZAZ. Rregullat për hedhjen e shortit përcaktohen me akt normativ të KQZ-së. Në zbatim të dispozitave të mësipërme kemi përgatitur dhe aktin e mësipërm. Qëllimi i këtij projektvendimi është të përcaktojë rregullat për hedhjen e shortit për renditjen e subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletën e votimit, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore duke u bazuar në parimet e transparencës dhe barazisë. Renditja e subjekteve zgjedhore dhe e kandidatëve për kryetar bashkie në fletën e votimit bëhet me short. Për përcaktimin e renditjes së partive politike dhe koalicioneve zgjedhore të regjistruara si subjekte zgjedhore në fletën e votimit për këshillin e bashkisë, shorti bëhet njëherësh për të gjitha zonat zgjedhore. Në renditjen përfundimtare kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për këshillin e bashkisë vendosen pas renditjes së partive politike dhe koalicioneve zgjedhore. Në rast se për një zonë zgjedhore regjistrohen 2 ose më shumë kandidatë të propozuar nga zgjedhësit, renditja midis tyre përcaktohet me short. Në rastin e përfundimit të hedhjes së shortit renditen njëra pas tjetrës subjektet zgjedhore të cilat kanë emrin zyrtar, emblemën, siglën ose shkronjat nistore të përafërta, që mund të shkaktojnë konfuzion apo lajthitje të votuesit. Me kërkesë të subjekteve shorti mund të përsëritet jo më shumë se dy herë të tjera deri në renditjen që nuk shkakton konfuzion të votuesit. Për përcaktimin e renditjes së kandidatëve për kryetar bashkie në fletën e votimit, për kryetar të bashkisë shorti bëhet për çdo zonë

2


**Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 23.02.2023**

zgjedhore ose bashki. Proceduara e hedhjes së shortit për renditjen e subjekteve dhe kandidatëve në fletën e votimit përcaktohet me 2 procese: parashortit dhe shortit. Në parashort përcaktohet radha nëpërmjet subjekteve zgjedhore për të tërhequr numrin që do të ketë në fletën e votimit. Shorti përcakton numrin që do të mbajë subjekti zgjedhor në fletën e votimit. Parashorti dhe shorti zhvillohen sipas proceduarave të mëposhtme: parashorti do të zhvillohet si më poshtë: KQZ-ja përcakton një person nga administrata për procesin e parashortit. Përgatiten shirita letre ku në to janë shënuar emrat e subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në short dhe sigurojnë numër goglash të barabarta me numrin e shiritave të letrës. Shiritat e letrës janë të barabartë dhe verifikohen për saktësi nëpërmjet ekspozimit nga nëpunësi i administratës, nga të gjithë të pranishmit. Goglat duhet të jenë të së njëjtës ngjyrë pa shenja dhe shënime, të njëjtës peshë e madhësi. Në tryezën ku hidhet shorti vendosen shiritat me numër rendor dhe gogla. Në secilën prej goglave futet nga një shirit i letrës dhe me pas goglat futen në një enë transparente dhe përzihen me qëllimin e sigurisë së barazisë për zgjedhje. Nëpunësi i administratës i KQZ-së pasi i përzier goglat, tërheq njërën prej tyre e hap dhe lexon emrin e subjektit zgjedhor, që është shënuar në shiritin brenda saj dhe ia dorëzon sekretarit të Përgjithshëm. Subjekti zgjedhor, që është shënuar në shiritin e letrës brenda goglës së parë, do të jetë i pari që do të tërheqë goglën në shortin që do të zhvillohet sipas procedurës së përcaktuar në pikën “b” të kësaj pike dhe kështu do të vazhdojë deri në tërheqjen goglave, që janë në enët transparente. Shorti do të zhvillohet me procedurë si më poshtë: përgatiten shirita letre, ku në secilën prej tyre shënohet një numër, duke filluar nga numri 1 deri te numri që është i barabartë...

**Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 23.02.2023**

**Znj. I. Nano:** Zoti Merkaj, ndjesë! Kjo është pjesë e projekaktit, që do të lexohet nga ana ime gjatë shqyrtimit dhe diskutimit në parim dhe nen për nen. Nëse mund t'i përmbledhim shpjegimet...

**Z. Y. Merkaj:** Po, pas përfundimit të shortit, për subjektet zgjedhore në fletën e votimit për këshillin e bashkisë, organizohet shorti për renditjen e kandidatëve në fletën e votimit për kryetar bashkie. Procedura e shortit është të projektvendimi. Bashkëlidhur kemi projektvendimin për shqyrtim e miratim. Ju faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit! Atëherë çelim diskutimin në parim të projektaktit, kolegë, dhe më pas përfaqësuesit e partive politike nëse kanë diçka në parim lidhur me projektaktin "Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletën e votimit në zgjedhje për organet e qeverisjes vendore." Zoti Kaziaj, ju keni diçka në parim? Faleminderit!

Kalojmë në votimin në parim të projektaktit,

**Kush është dakord?**

**Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)**


**Kundër: S'ka.**

*Me 5 vota pro miratohet.*

Kalojmë nen për nen ose pikë për pikë. Kemi 6 të tilla.

**Pika 1, neni 1:** Objekti. Ky vendim përcakton rregullat për hedhjen e shortit për renditjen e subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, duke u bazuar në parimin e transparencës dhe barazisë.

**Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 23.02.2023**

***Kush është dakord, kolegë?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)***


***Kundër: S'ka.***

*Miratohet neni 1 me 5 vota pro.*

Neni 2 “Renditja e subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve për kryetar të njësive të qeverisjes vendore në fletët e votimit.” Pika 1. Renditja e subjekteve zgjedhore dhe e kandidatëve për kryetar të njësive qeverisjes vendore në fletët e votimit bëhet me short. Pika 2. Për përcaktimin e renditjes së partive politike dhe koalicioneve zgjedhore të regjistruara si subjekte zgjedhore, në fletën e votimit për këshillin e bashkisë shorti bëhet njëherësh për të gjitha zonat zgjedhore. Në renditjen përfundimtare kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për këshillin e bashkisë vendosen pas renditjes së partive politike dhe koalicioneve zgjedhore. Në rast se për një zonë zgjedhore regjistrohen 2 ose më shumë kandidatë të propozuar nga zgjedhësit, renditja midis këtyre përcaktohet me short. Pika 3. Në rast se në përfundim të hedhjes së shortit renditen njëri pas tjetrit subjekte zgjedhore të cilat kanë emrin zyrtar, emblemën, siglën apo shkronjat nistore të përafërta dhe që mund të shkaktojnë konfuzion ose lajthitje të votuesit, me kërkesë të subjekteve, shorti mund të përsëritet jo më shumë se 2 herë të tjera deri në renditjen që nuk shkakton konfuzion te votuesit. 4. Për përcaktimin e renditjes së kandidatëve për kryetar bashkie në fletën e votimit për kryetar të bashkisë, shorti bëhet për çdo zonë zgjedhore (bashki).” Në fakt, është renditje e kandidatëve për kryetar bashkie, pastaj kjo është cilësimi “në fletën e votimit për kryetar bashkie”, meqë kemi dy fletë. Kemi diçka për nenin 2, nëse doni edhe ndonjë sqarim të mëtejshëm nga ana e administratës, sepse kemi si rendin për partitë politike dhe koalicionet zgjedhore,

5

**Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa**





**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 23.02.2023**

që regjistrohen si të tilla, dhe më tej kemi edhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit që vendosen pas në listë, në fletën e votimit.

**Z. M. Koja:** Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit si këshilltarë renditen në përfundim, ndërsa kandidatët e propozuar nga zgjedhësit si kryetar bashkie do të hidhen në short bashkë me kandidatët e tjerë në mënyrë të barabartë.

**Znj. I. Nano:** Ndonjë sqarim tjetër, ndonjë pyetje tjetër për administratën? Po, zonja Vukaj.

**Znj. H. Vukaj:** Keni bërë teste paraprake, apo keni parasysh përvojat e mëparshme?

**Znj. M. Koja:** Është njëlloj si përvoja e mëparshme, si vendimi që ka qenë në fuqi deri në zgjedhjet pararendëse për pushtetin vendor.

**Znj. I. Nano:** Nëse nuk ka pyetje të tjera, kalojmë në votimin e nenit 2.

**Kush është dakord?**


**Pro: 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)**

**Kundër: S'ka.**

*Miratohet neni 2 me 5 vota pro.*

“Neni 3. Veprimet paraprake përpara hedhjes së shortit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve njofton përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore për datën, vendin dhe orën e caktuar për organizimin e shortit. Data, vendi dhe ora e zhvillimit të shortit publikohen në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Pika

**Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 23.02.2023**

3. Mosparaqitja e ndonjë prej përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore nuk pezullon procedurat e shortit. Në këtë rast caktohet një nëpunës i administratës së KQZ-së të realizojë procedurën e parashikuar në këtë vendim për subjektin zgjedhor, përfaqësuesi i të cilit nuk është i pranishëm.” Kemi përfaqësues të partive politike këtu. Keni ndonjë shqetësim lidhur me këtë? Është një procedurë e përdorur edhe në zgjedhje të tjera. Nëse mungon përfaqësuesi i subjektit zgjedhor, atëherë do të flasim për subjekt zgjedhor, sot flasim për përfaqësues të partive politike në KQZ, atëherë të ngarkohet një zyrtar i KQZ-së për të tërhequr shortin. Ka ndonjë shqetësim nga ana juaj?

**Z. A. Kaziaj:** Jo, vetëm një specifikim i lidhur me pikën 3 të nenit 3, mosparaqitja e ndonjë prej përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore, atë që është detyra e pikës 1, të njoftimit të subjekteve zgjedhore, të përfaqësuesve të tyre, mund të vihet një togfjalësh tjetër “pas marrjes së njoftimit sipas pikës 1”. Të paktën sipas mendimit tim, sepse mosparaqitja lidhet automatikisht thoni ju me pikën 1 që është njoftuar...

**Znj. I. Nano:** Është njoftuar subjekti, është njoftuar edhe në faqen zyrtare.

**Z. A. Kaziaj:** Faqja zyrtare nuk është njoftim, është publikim për të tretët.

**Znj. I. Nano:** Pika 1 nuk flet për faqen zyrtare. Ky është hapi i tretë mosparaqitja. Hapi i parë është njoftimi i subjekteve zgjedhore në mënyrë individuale. Hapi i dytë është njoftimi publik në faqen zyrtare dhe hapi i tretë nëse nuk paraqitet. Besoj që nga eksperiencia e deritanishme...

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 23.02.2023*

**Z. A. Kaziaj:** Nuk ka pasur raste hipotetike, por fakti është që për një shkak të natyrës së paparashikueshmërisë nuk njoftohet përfaqësuesi i subjektit, nuk duhet të hyjë te pika 3. Në fakt, një togfjalësh i tillë eviton...

**Znj. I. Nano:** Ky është një moment shumë i rëndësishëm për subjektet zgjedhore dhe ka një interes të veçantë.

**Z. A. Kaziaj:** Kjo nuk do të thotë që KQZ-ja nuk do të bëjë detyrën e vet, pavarësisht interesit të një subjekti zgjedhor.

**Znj. I. Nano:** Do ta bëni detyrën tuaj, zoti Sekretar i Përgjithshëm, nëse do ta miratojmë këtë akt që detyron administratën për të bërë njoftimin?

**Z. Y. Merkaç:** Patjetër. Ligji thotë që mosparaqitja e tyre nuk pezullon procedurën e shortit. Kështu që do të vazhdojë shorti.

**Znj. I. Nano:** Faleminderit! Kolegët kanë ndonjë diskutim lidhur me këtë çështje? Kalojmë në votimin e nenit 3. Keni ndonjë propozim zoti Kaziaj.

**Z. A. Kaziaj:** Unë e bëra propozimin, por meqë këtu ligj është fjala e Sekretarit të Përgjithshëm dhe garancitë që jep ai janë sublimë, kështu që po ia lëmë kryetares ta vendosë me Sekretarin e Përgjithshëm këtë gjë.

**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 23.02.2023**


**Znj. I. Nano:** Në fakt, ne në çdo vendim ngarkojmë administratën për zbatimin dhe besoj që administrata e ka dëshmuar këtë përgjegjësi maksimale në zbatimin e vendimeve jo vetë të Rregullatorit.

**Znj. H. Vukaj:** Ka pasur raste të mëparshme kur subjektet nuk janë njoftuar dhe, për hir të mosnjoftimit apo cedimit në këtë lloj faze procedurale, ata nuk janë paraqitur dhe e kanë dëshmuar këtë?

**Z. Y. Merkaç:** Nuk ka pasur raste që nuk janë paraqitur dhe rastet kur janë paraqitur kanë qenë prezent, ngaqë janë supersticiozë, nuk e kanë tërhequr vetë, përsëri kanë autorizuar përfaqësuesit e KQZ-së për ta tërhequr.

**Znj. I. Nano:** Kam përshtypjen që votuam, kolegë, dhe neni 3 mori dakordësinë e të pestëve ne. “Neni 4. Procedura e hedhjes së shortit për renditjen e subjekteve dhe kandidatëve në fletën e votimit. Pika 1. Renditja për subjektet zgjedhore përcaktohet nëpërmjet dy proceseve, parashortit dhe shortit. Në parashort përcaktohet radha ndërmjet subjekteve zgjedhore për të tërhequr numrin që do të ketë në fletën e votimit. Shorti përcakton numrin që do të mbajë subjekti zgjedhor në fletën e votimit. Parashorti dhe shorti zhvillohen sipas procedurës së mëposhtme: a) Parashorti zhvillohet si më poshtë: KQZ-ja cakton një person nga administrata për procesin e parashortit. Përgatiten në shirita letre emrat e subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në short dhe sigurohen numër goglash i barabartë me numrin e shiritave. Shiritat e letrës janë të barabartë dhe verifikohen për saktësi nëpërmjet ekspozimit nga nëpunësi i administratës, nga të gjithë të pranishmit. Goglat duhet të jenë të së njëjtës ngjyrë, pa shenja apo shënime dhe të

**Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa**




**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 23.02.2023**

së njëjtës peshë e madhësi. Në tryezën ku hidhet shorti vendosen shiritat me numrat rendorë dhe goglat. Në secilën prej goglave futet nga një shirit letre e më pas goglat futen në një enë transparente. Goglat përzihen me qëllim sigurimin e barazisë në përzgjedhje. Nëpunësi i administratës së KQZ-së, pasi i përzien goglat, tërheq një prej tyre, e hap, lexon emrin e subjektit zgjedhor që është shënuar në shiritin brenda saj dhe ia dorëzon Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së. Subjekti zgjedhor që është shënuar në shiritin e letrës brenda gogles së parë, do të jetë i pari që do të tërheqë goglen në shortin që do të zhvillohet sipas procedurës së përcaktuar në shkronjën “b” të kësaj pike, e kështu do të vazhdohet deri në tërheqjen e të gjitha goglave brenda në enë. b) Shorti zhvillohet si më poshtë: Përgatiten shirita letre ku në secilin prej tyre shënohet një numër duke filluar nga numri 1 deri tek numri i barabartë me numrin e subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në short dhe sigurohen numër goglash i barabartë me numrin e shiritave. Shiritat e letrës dhe goglat plotësojnë kriteret e nënndarjes “ii” të shkronjës “a” të kësaj pike. Shiritat verifikohen për saktësi nëpërmjet ekspozimit nga nëpunësi i administratës, nga të gjithë të pranishmit. Në tryezën ku hidhet shorti vendosen shiritat me numrat rendorë dhe goglat. Në secilën prej goglave futet nga një shirit letre e më pas goglat futen në një enë transparente. Goglat përzihen me qëllim sigurimin e barazisë në përzgjedhje. Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore tërheqin nga ena një gogël sipas radhës së përcaktuar në parashort. Përfaqësuesi i subjektit zgjedhor hap goglen dhe lexon numrin që është shënuar në të. Ky numër do të jetë numri rendor që subjekti zgjedhor do të ketë në fletën e votimit për këshillin e bashkisë.” Deri këtu çka u lexova, pika 1 lidhet me parashortin dhe shortin lidhur me fletën për këshillin e bashkisë. Po, zonja Koja.

10

**Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa**




**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 23.02.2023**

**Z. M. Koja:** Doja thjesht të bëja një saktësim në shkronjën “b”, nënndarja e parë, në fjalinë e parafundit “Shiritat e letrës dhe goglat plotësojnë kriteret e nënndarjeve “i” dhe “ii””, sepse janë të përcaktuar në dy nënndarje. Kur ju e lexuat, e konstatova, kështu që, nëse është e mundur, ta votojmë në këtë mënyrë. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** “Nënndarjeve “i” dhe “ii””. Kjo do të korrigjohet gjatë zbardhjes së projektvendimit. Për pikën 1 kemi ndonjë pyetje që të mos ecim më gjatë, sepse ka informacion dhe procedurë të ngarkuar projektvendimi? Nuk kemi. Kalojmë te pika 2 dhe pastaj e votojmë në tërësi nenin. “Pas përfundimit të shortit për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për këshillin e bashkisë, organizohet shorti për renditjen e kandidatëve në fletën e votimit për kryetar bashkie. Pika 3. Renditja e kandidatëve për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore përcaktohet nëpërmjet shortit, sipas procedurës së mëposhtme: përgatiten shirita letre të barabartë me numrin e kandidatëve të regjistruar për kryetarë të njësisë së qeverisjes vendore. Në secilin prej shiritave shënohen emrat e kandidatëve për kryetarë. Sigurohen numër goglash i barabartë me numrin e shiritave. Goglat duhet të jenë të së njëjtës ngjyrë, pa shenja apo shënime dhe të së njëjtës peshë e madhësi. Në secilën prej goglave futet nga një shirit letre dhe goglat futen në një enë transparente. d. Goglat përzihen me qëllim sigurimin e barazisë në përzgjedhjeje; e. Nëpunësi i administratës tërheq nga ena një gogël, e nxjerr, hap shiritin e letrës dhe lexon emrin e kandidatit të shënuar në të, duke e ekspozuar për të gjithë të pranishmit. Emri i kandidatit që shënohet në shiritin e parë që tërhiqet do të mbajë numrin 1 në fletën e votimit. Kështu vijohet me radhë rritëse deri në tërheqjen e të gjitha goglave brenda në enë; 4. Administrata e KQZ-së

11

**Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 23.02.2023**


mban procesverbalin e rezultateve të shortit. Duke qenë që pika 3 përmban procedurën e shortit për renditjen e kandidatëve për kryetar bashkie, pra kryetarët e njësisë së qeverisjes vendore, në fletën përkatëse të votimit, kemi ndonjë pyetje, apo kërkesë për t'u sqaruar më tej nga administrata? Sqarimi është dhënë më herët në pikën 2 që shorti bëhet për çdo zonë zgjedhore. Pra, konkretisht në pikën 3 të nenit 4 është procedura e një shorti, i tillë do të hidhet në të gjitha meqenëse është vendosur dhe më sipër e votuam.

**Znj. H. Vukaj:** Unë mendoj se ndoshta përveç narracionit dhe leximit të pikave, mund të bëni një rezymë të shkurtër si procedohet, që publiku të jetë më i qartë nga ajo që ju keni aplikuar.

**Znj. M. Koja:** Do të bëhet renditja për të dyja fletët e votimit: fleta e votimit për këshillin e bashkisë dhe fleta e votimit për kryetarin e bashkisë. Në radhë të parë hidhet shorti për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit të për këshillin e bashkisë dhe më pas vijohet me hedhjen e shortit për renditjen e kandidatëve për kryetar të bashkisë. Procedura e parë parashikon parashortin dhe shortin. Numri që do të marrë subjekti zgjedhor duhet të jetë i njëjtë për të gjithë vendin, është në rang vendi, pavarësisht se subjekti do të përfaqësohet me kandidatura në çdo bashki ose jo. Ndërsa për kryetar të bashkisë do të hidhen 61 shorte dhe renditja do të jetë individuale për çdo bashki sipas rezultateve të shortit. Kjo është procedura e thënë më thjesht.

**Znj. I. Nano:** Dakord. A keni ndonjë pyetje? Po, zoti Kaziaj.

**Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 23.02.2023**

**Z.A. Kaziaj:** Unë kam një saktësim, e nderuar zonja kryetare, sa i përket pjesës së elementeve që janë në hedhjen e shortit janë kryesisht tri elemente ose tri sende: janë shiritat me numrat rendor, goglat dhe ena transparente ku bëhet shortimi. Ndërkohë që, referuar pikës 1, shkronjës “a” “iii”, thuhet: “Në tryezën ku hidhet shorti vendosen shiritat me numrat rendorë dhe goglat”. Po ena transparente ku është menduar të lihet, meqenëse është pjesë e procesit?

**Znj. I Nano:** Goglat futen në një enë transparente. Ti thua të vendoset edhe ena ku vendosen shiritat, sepse supozohet se ena është në tryezë.

**Z. A. Kaziaj:** Është elementi i tretë, pse duhet të supozohet. Atëherë supozojmë që edhe goglat janë në tryezë, pse i vëmë ato. Pra është e njëjta gjë dhe përsëritet edhe te shkronja “b” “ii”.

**Znj. I Nano:** Edhe te pika 1, shkronja “a” “iii”, edhe te shkronja “b” “ii”, zoti Kaziaj? Atëherë, ta konsiderojmë propozim, që ta votojmë. Pra, në të dy këto shkronja duhet: “Në tryezën ku hidhet shorti vendoset ena transparente, shiritat me numrat rendor dhe goglat”. Kolegë votojmë propozimin e zotit Kaziaj për të shtuar edhe enën transparente bashkë me materialet e tjera, të cilat shërbejnë për hedhjen e shortit. Te neni 4, pika 1, shkronja “a”, nënndarja “iii”, dhe tek i njëjti nen, pika 1, shkronja “b”, nënndarja “ii”. Votojmë propozimin e zotit Kaziaj.


**Kush është dakord?**

**Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)**

**Kundër: S’ka.**

*Me 5 vota pro miratohet.*

**Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa**





**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 23.02.2023**

Nuk kemi propozim tjetër për këtë nen, kështu që ta votojmë në tërësi nenin 4 me ndryshimin që sapo miratuam.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)***

***Kundër: S'ka.***

*Miratohet me 5 vota pro.*

Kërkoj ndjesë, në këtë nen kishim edhe një pikë 4. “Administrata e KQZ-së mban procesverbalin e rezultateve të shortit”.

Neni 5. “Rezultati i shortit. Komisioneri shtetëror i Zgjedhjeve miraton me vendim rezultatin e shortit për renditjen e subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve për kryetar bashkie në fletët e votimit për çdo zonë zgjedhore, bashki.”

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)***

***Kundër: S'ka.***

*Miratohet neni 5 me 5 vota pro.*


Neni 6. “Hyrja në fuqi dhe ankim. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohen në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.”

Pika 2. “Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegji Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga shpallja e tij”. Mungon si zakonisht, ose si disa herë. Duhet, të shtojmë: “Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e tij.”

Në fakt, administrata ngarkohet saktësisht për këtë. Kemi një seancë publike ku hidhet shorti dhe vetë sekretari i Përgjithshëm me administratën realizojnë këtë proces. Votojmë nenin 6.

***Kush është dakord?***

**Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 23.02.2023*

*Pro: 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, zgj.Vukaj, z. Çakaj)*

*Kundër: S'ka.*

*Miratohet me 5 vota pro.*

Kalojmë në miratimin në tërësi të projektvendimit.

*Kush është dakord?*


*Pro: 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, zgj.Vukaj, z. Çakaj)*

*Kundër: S'ka.*

*Miratohet me 5 vota pro.*

**Vendimi nr. 8**

*Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 23.02.2023*

**Data 23.02.2023  
Ora, 19:03**

**JASHTË RENDI I DITËS**

**PJESËMARRJA:**


- **KQZ:**
- **Komisioni Rregullator:**

<b>Ilirjana NANO</b>	<b>Kryetare</b>
<b>Arens ÇELA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Dritan ÇAKA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Helga VUKAJ</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Muharrem ÇAKAJ</b>	<b>Anëtar</b>
- **Stafi i KQZ-së:** **Y. Merkaj, M. Koja**
  - **Parti Politike:** **PL (A. Kaziaj)**
  - **OJQ:** **KRIIK**

*Znj. I. Nano:* Zonja Vukaj ka kërkuar fjalën për çështje jashtë rendit të ditës.

*Znj H. Vukaj:* Faleminderit! Të nderuar kolegë, më lejoni të përdor këtë mbledhje publike, për të bërë një falënderim publik, sepse vërtet e ndjej se duhet ta bëj për një organizatat më të rëndësishme, që merret me procesin zgjedhor, OSBE-ODIHR-i, pasi mediatikisht jemi njohur këto ditë me angazhimin e saj maksimal në vlerësim të situatës, sigurisht, me prezencë të shtuar dhe të parakohshme të vëzhguesve dhe ekspertëve të saj. Kjo, absolutisht nga ana ime, me autoritetin, që më jep ligji, si një nga drejtuesit në tërësinë e strukturave drejtuese të këtij

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 23.02.2023**

institucioni, do të doja të mos e anashkaloja këtë falënderim, sepse është vërtet për t'u përshëndetur. Së dyti, përshëndes kolegun, Komisionerin Celibashi, i cili ka nxjerrë një alert kujtesë për administratën për deklarimin e veprimtarive të tyre në këtë institucion, që, me sa duket jemi në kushtet e alertit. Së treti, por jo më pak e rëndësishme, është shumë e rëndësishme, është bërë përsëri, e vyera medie, pjesë e dhënies të këtij informacioni personit tim, por edhe të gjithë shqiptarëve për fenomenin "tren bullgar" quhet në gjuhën tonë ose mund të kemi edhe versione të tjera të këtij fenomeni, ku del fleta e parë e votimit, pra, praktikisht ndodh që del fleta e parë e votimit dhe kjo përcillet zinxhir te votuesit. Atëherë, duke e marrë informacion nga media, që shteti italian e ka zgjidhur në zgjedhjet e fundit këtë fenomen, i kërkoj administratës zgjedhore t'i nisë kërkesë ambasadës italiane të na mundësojë me modusin e përdorur, bazën ligjore të përdorur dhe mundësisht procedurën e implementimit të kësaj risie apo gjetje, do ta quaja, për t'i dhënë fund këtij fenomeni. Gjithashtu, në këtë kuadër, u bëj thirrje edhe trupave të tjera diplomatike, nëse ata disponojnë modalitet parandalues apo paralizues të këtij fenomeni, u lutem të na ndihmojnë, të na e përcjellin në KQZ, me qëllim që, në dinamizmin tonë të shtojmë edhe një akt, i cili të ndihmojë procesin zgjedhor, të jetë *faire*, të jetë i drejtë dhe t'u jepet fund njëherë e përgjithmonë këtyre fenomeneve, të cilat i përkasin vendeve jodemokratike. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit, zonja Vukaj! A keni ndonjë tjetër për të shtuar? Nëse nuk kemi diçka tjetër për të shtuar, mbledhjen e deklaroj të mbyllur!

**Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ**

